REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 392/13 Data: 15.01.13
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 392/13
Datë 15-01-2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.12.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e Qendrës Trajnuese "KEK", për periudhën: 15.12.2012 - 31/07/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Teknologji Informative dhe e komunikimit - (niveli i KKK-së II)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Programi i zbatuar për trajnimin e ECDL ka si përmbajtje sistemin operativ Windows XP dhe Microsoft Office 2003. Rekomandohet që të bëhet përditësim i programit, në mënyrë që kandidatëve të mund të ju ofrohet trajnimi për versionet e fundit të sistemit operativ dhe paketës së Office-it.
- Rekomandohet që të krijohet një plan i trajnimit dhe certifikimit të trajnerëve me programet më te reja që ofron kjo qendër (Office 2010)

Afati përmbushjes se këtyre kushteve është: 01.07.2013

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 15.12.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:
-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- QT "KEK";
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi